



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Kontakti me botën e jashtme të të paraburgosurve dhe personave të dënuar me heqje lirie

Ky material është përgatitur nga Qendra ALTRI në kuadër të projektit “*Kontribimi në Përmirësimin e Standardeve të të Drejtave të Njeriut brenda dhe jashtë Sistemit të Burgjeve në Shqipëri*” i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në partneritet me Fondacionin Qendra Evropiane në Shqipëri.

**Përmbajtja e këtij dokumenti pasqyron pikëpamjet e autorit dhe nuk pasqyron
domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian**

Tiranë 2021

Kontaktin me botën e jashtme të të paraburgosurve dhe personave të dënuar me heqje lirie

Të paraburgosurit dhe të dënuarit gëzojnë të drejtën e respektimit të jetës private e familjare si e drejtë themelore; autoritetet përgjegjëse shtetërore kanë detyrimin pozitiv për t'ua mundësuar dhe kur është e nevojshme t'i asistojnë/ndihmojnë në realizimin e kësaj të drejte dhe mbajtjen e kontakteve me familjen e tyre.

Në këtë punim paraqiten të përmbledhura standartet e vendosura nga legjislacioni ynë dhe ai evropian për të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve për kontaktin e tyre me botën e jashtme të lidhura posaçërisht me:

1. kontaktin me familjen dhe vizitat;
2. informimin mbi çështjet familjare dhe sociale;
3. të drejtën për t'u martuar.

1. Kontaktin me familjen dhe vizitat.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisëⁱ dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)ⁱⁱ garantojnë për çdo person:

- të drejtën për të gëzuar respekt të jetës private, familjare, banesës dhe korrespondencës.
 - Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet vetëm me ligj dhe në rastet kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike apo për parandalimin e krimit.ⁱⁱⁱ

Legjislacioni shqiptar parashikon që institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të burgosurit me familjen. Në këtë drejtim, **ligji “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”^{iv}** dhe **Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve**^v parashikojnë standartet vijuese:^{vi}

- të burgosurit kanë të drejtë të takohen 4 herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tyre, ndërsa për të miturit dyfishohet kjo e drejtë me takime 8 herë në muaj;
 - kohëzgjatja e takimeve është të paktën 1 (një) orë; takimet e zgjatura lejohen deri në 5 (pesë) orë për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues;
 - në burgjet e sigurisë së lartë, në raste të veçanta mund të zbatohet një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave për të dënuarit, i cili, ndër të tjera konsiston në takimin një herë në muaj me anëtarët e familjes;^{vii}
 - në çdo takim, lejohen fëmijët e mitur dhe tre persona madhorë;
- të paraburgosurit dhe të dënuarit i lejohet 8 herë në muaj biseda telefonike me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tij, ndërsa për të dënuarit e mitur dhe gra lejohet 16 herë në muaj;

- për të paraburgosurit dhe burgosurit që nuk kanë mjete financiare, biseda telefonike i lejohet një herë në muaj deri në 5 minuta me shpenzimet e institucionit.

Disa nga standarte për të drejtat e të burgosurve për kontaktin e tyre me familjen dhe vizitat të parashikuara në *Rregullat Evropiane të Burgjeve*^{viii} paraqiten të përmbledhura në vijim:^{ix}

- të burgosurit duhet të lejohen të komunikojnë sa më shpesh të jetë e mundur me anë të letrave, telefonit ose formave të tjera të komunikimit me familjet e tyre, persona të tjerë dhe përfaqësues të organizatave të jashtme dhe të marrin vizita nga këta persona;
- komunikimi dhe vizitat mund të jenë subjekt i kufizimeve dhe monitorimit të nevojshëm – të urdhëruara nga gjykata - për kërkesat e vazhdimet të hetimeve penale, mirëmbajtjen e rendit, sigurinë, parandalimin e veprave penale dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;
- marrëveshjet për vizitat duhet të jenë të tilla që të lejojnë të burgosurit të mbajnë dhe zhvillojnë marrëdhëniet familjare në një mënyrë sa më normale;
 - autoritetet e burgut duhet të ndihmojnë të burgosurit në mbajtjen e kontakteve të përshtatshme me botën e jashtme.

GJEDNJ, përmes jurisprudencës së saj, ka mbajtur këto qëndrime:^x

- çdo ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare duhet të jetë e justifikueshme në raport me kufizimet e parashikuara në nenin 8 paragrafi 2^{xi} të KEDNJ. Në veçanti, çdo ligj mbi të cilin bazohen kufizimet në vizitat familjare duhet të plotësojë kërkesën e "cilësisë së ligjit" sipas nenit 8;
- vendosja e disa kufizimeve të ndryshme afatgjata dhe të ashpra në mundësinë e kërkuesit për të marrë vizita në burg, si dhe dështimi i regjimit të vizitave në burg është në kundërshtim me nenin 8 të Konventës , për shkak të përparësisë që i duhet dhënë parimit të proporcionalitetit dhe nevojës për rehabilitim dhe ri-integrim të të burgosurve me dënim të gjatë.^{xii}

2. Informimi mbi çështjet familjare dhe sociale

Të burgosurit duhet t'i komunikohet menjëherë nga institucioni çdo informacion i marrë për vdekjen ose sëmundjen e rëndë të ndonjë të afërmi. *Ligji "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve"*^{xiii} dhe *Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve*^{xiv} parashikojnë në këto raste leje të veçantë për të dënuarit; veçoritë e lejes në të tilla raste janë:^{xv}

- jepet me kohëzgjatje deri në 48 orë dhe bëhet me shoqërim vetëm gjatë ditës;
- vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, mund të zgjatet me kërkesë të të dënuarit edhe 24 orë të tjera me miratimin e drejtorit të institucionit të vuajtjes së dënimit (për të paraburgosurin duhet miratimi paraprak i prokurorit):
 - kjo leje e veçantë jepet për raste sëmundjesh të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes së të paraburgosurit apo të dënuarit dhe kërkesa për leje duhet

të shoqërohet me raportin mjekësor të familjarit të sëmurë ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore e tij;

- mund të jepet edhe në rastet te ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit;
- periudha e lejes përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

Të drejta të tjera të parashikuara për të dënuarin/paraburgosurin në raport me familjen dhe informimin për çështjet familjare përmenden të përmbledhura në vijim:^{xvi}

- i burgosuri ka të drejtë të informojë menjëherë anëtarët e familjes për futjen e tij në institucion ose kur transferohet prej tij. Me pëlqim të të burgosurit, komunikimi mund të bëhet edhe nga personeli i institucionit;
- institucioni njofton menjëherë anëtarët e familjes në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike, plagosje të rëndë të një të burgosuri ose transferimin e tij në qendrën spitalore të burgjeve.

Disa nga standartet për të drejtat e të burgosurve për informimin e tyre mbi çështjet familjare dhe sociale të parashikuara në *Rregullat Evropiane të Burgjeve*^{xvii} paraqiten të përmbledhura në vijim:^{xviii}

- të burgosurit duhet të lejohen të kenë mundësi të informohen rregullisht për çështjet publike (duke u regjistruar dhe lexuar gazeta, revista periodike dhe botime të tjera dhe duke dëgjuar transmetime në radio ose television), përveç nëse ekziston një ndalim specifik për një periudhë të caktuar nga një autoritet gjyqësor në një çështje individuale;
- autoritetet e burgut duhet të sigurojnë që të burgosurit të jenë në gjendje të marrin pjesë në zgjedhje, referendume dhe në aspekte të tjera të jetës publike, për aq sa e drejta e tyre për ta bërë këtë nuk është e kufizuar nga ligji kombëtar;
- të burgosurit duhet të lejohen të informojnë familjet e tyre menjëherë për burgosjen ose transferimin e tyre në një institucion tjetër dhe për çdo sëmundje të rëndë ose dëmtim që mund të pësojnë. Pas pranimit të një të burgosuri në burg, vdekjes ose sëmundjes së rëndë, ose plagosjes së rëndë të një të burgosuri, ose transferimit të një të burgosuri në një spital, autoritetet duhet të informojnë menjëherë (përveç nëse i burgosuri u ka kërkuar atyre të mos e bëjnë këtë) bashkëshortin/en ose partnerin/en e të burgosurit, ose, nëse i burgosuri është beqar, i afërmi më i afërt dhe çdo person tjetër i caktuar më parë nga i burgosuri;
- të burgosurit duhet t'i komunikohet menjëherë nga institucioni çdo informacion i marrë për vdekjen ose sëmundjen e rëndë të ndonjë të afërmi;
- kurdoherë që e lejojnë rrethanat, i burgosuri duhet të lejohet të largohet nga burgu (i shoqëruar me eskortë ose vetëm) për të vizituar një të afërm të sëmurë, për të marrë pjesë në një funeral ose për arsye të tjera njerëzore;
- të burgosurit i lejohej të komunikojë me median përveç nëse ka arsye bindëse për ta ndaluar këtë për ruajtjen e sigurisë, në interes të publikut ose për të mbrojtur integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose personelit.

Në këtë drejtim, *GJEDNJ, përmes jurisprudencës së saj*, është shprehur se:^{xix}

- **neni 8 i KEDNJ**, që parashikon të drejtën për respektimin e të drejtës private dhe familjare, **nuk i garanton një personi të ndaluar një të drejtë të pakushtëzuar për të vizituar** një të afërm të sëmurë ose për të marrë pjesë në varrimin e një të afërmi; **u takon autoriteteve vendase të vlerësojnë secilën kërkesë për meritat e saj.**^{xx}

3. E drejta për t'u martuar

Ligji “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”^{xxi} dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve^{xxii} parashikojnë për të drejtën për t'u martuar për të paraburgosurit ose të dënuarit siç vijon:^{xxiii}

- ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim e paraburgim e nënkupton të drejtën për t'u martuar të një të paraburgosuri apo të dënuari, kur parashikon mbajtjen e një regjistri të veçantë për martesat e lidhura në institucion:
 - *“Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale evidenton në një regjistër të veçantë faktet e lindjeve, martesave ose vdekjeve të ndodhura në institucion.”;*
- Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve parashikon shprehimisht mundësinë e shoqërimit të të dënuarit apo të paraburgosurit në zyrën e gjendjes civile për lidhje martese:
 - *“Të paraburgosurit apo të dënuarit shoqërohen në zyrën e gjendjes civile për lidhje martese apo për aplikimin për kartë identiteti ose pasaportë.”*

Në lidhje me të drejtën për t'u martuar KEDNJ në nenin 12 të saj parashikon se: *“Burrat dhe gratë në moshë martesore kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë një familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.”*. Referuar kësaj dispozite **GJEDNJ, përmes jurisprudencës së saj**, është shprehur se:^{xxiv}

- **të paraburgosurit dhe të burgosurit kanë të drejtë të martohen, pasi liria personale nuk është kusht për t'u martuar.** Paraburgimi apo burgimi privon një person nga liria dhe gjithashtu, në mënyrë të pashmangshme nga disa të drejtave dhe privilegjeve civile. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që personat në paraburgim apo burgim nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u martuar. (...) Personat e ndaluar nuk e humbin të drejtën e tyre të garantuar nga neni 12 thjesht për shkak të statusit të tyre. (...) Zgjedhja e një partneri dhe vendimi për t'u martuar, qoftë në liri apo në paraburgim/burgim, është një çështje rreptësisht private dhe personale dhe nuk ekziston asnjë model universal ose gjerësisht i pranuar për një zgjedhje apo vendim të tillë.^{xxv}

ⁱ Nenet 36, 37 dhe 53 të Kushtetutës së RSH (Ilgj nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar); aksesuar në:

<https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>.

ⁱⁱ Neni 8 i KEDNJ. Tekstin në gjuhën shqipe të KEDNJ mund ta gjeni në linkun vijues:

https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqj.pdf.

iii Neni 8 i KEDNJ. Tekstin në gjuhën shqipe të KEDNJ mund ta gjeni në linkun vijues:

https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqj.pdf.

iv Bëhet fjalë për Ligjin Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Tekstin e plotë mund ta gjeni në linkun vijues:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200702104324ligj%20nr.%2081,%20dt%2025.6.2020.pdf>.

v Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve mund të aksesohet në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në linkun vijues:

<http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=516>.

vi Për më tepër shih: Ligji Nr. 81/2020, nenet 17 dhe 49; Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, nenet 40-42.

vii Për informacion më të detajuar shih nenin 17 të ligjit nr. 81/2020.

viii Bëhet fjalë për Rekomandimin REC (2006) 2 të Këshillit të Ministrave për Vendet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve. Në gjuhën shqipe mund ta gjeni në linkun vijues:

https://Search.Coe.Int/Cm/Pages/Result_Details.aspx?Objectid=09000016805d8d25.

ix Për më tepër shih: Rregullat Evropiane të Burgjeve, pikat 24.1-24.5.

x Për më tepër shih: Council of Europe/European Court of Human Rights, 2021: *Guide on the case law of the European Convention of Human Rights – Prisoner’s rights*, faqe 21-25, aksesuar në linkun:

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf.

xi Neni 8 paragrafi 2 i KEDNJ parashikon se: “Nuk do të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte përveç asaj që është në përputhje me ligjin dhe është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike në interes të kombëtar sigurinë, sigurinë publike ose mirëqenien ekonomike të vendit, për parandalimin e çrregullimeve ose krimi, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerët.”

xii Po aty: Këtë konkluzion GJEDNJ e arriti në çështjen Khoroshenko kundër Rusisë, ku trajtoi një situatë në të cilën kërkuesi për dhjetë vjet kishte mbajtur kontakte me botën e jashtme përmes korrespondencës me shkrim, por i ishin kufizuar të gjitha format e tjera të kontaktit. Gjatë kësaj kohe, atij nuk i ishte dhënë mundësia të bëjë telefonata përveç ndonjë rasti urgjence, mund të merrte vetëm një vizitë çdo gjashtë muaj nga dy vizitorë të rritur. Në këto takime, që zgjatnin deri në katër orë, ai u nda nga të afërmit e tij me një ndarje qelqi, ndërkohë që një roje burgu kishte qenë i pranishëm dhe brenda distancës së dëgjimit në çdo kohë. Këto kufizime ishin të vendosura drejtpërdrejt nga ligji dhe ishin aplikuar për aplikantin vetëm për shkak të dënimit të tij të përjetshëm, pavarësisht nga ndonjë faktor tjetër. Regjimi ishte i zbatueshëm për një periudhë fikse prej dhjetë vjetësh, që mund të zgjatet në rast të sjelljes së keqe, por nuk mund të shkurtohet.

xiii Bëhet fjalë për Ligjin Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Tekstin e plotë mund ta gjeni në linkun vijues:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200702104324ligj%20nr.%2081,%20dt%2025.6.2020.pdf>.

xiv Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve mund të aksesohet në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në linkun vijues:

<http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=516>.

xv Për më tepër shih: Ligji Nr. 81/2020, nenet 48(5) dhe 73; Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, nenet 50 dhe 53.

xvi Për më tepër shih: Ligji Nr. 81/2020, neni 48.

xvii Bëhet fjalë për Rekomandimin REC (2006) 2 të Këshillit të Ministrave për Vendet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve. Në gjuhën shqipe mund ta gjeni në linkun vijues:

https://Search.Coe.Int/Cm/Pages/Result_Details.aspx?Objectid=09000016805d8d25.

xviii Për më tepër shih: Rregullat Evropiane të Burgjeve, pikat 24.6-24.12.

xix Për më tepër shih: Council of Europe/European Court of Human Rights, 2021: *Guide on the case law of the European Convention of Human Rights – Prisoner’s rights*, faqe 22-24, aksesuar në linkun:

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf.

xx Vëzhgimi i Gjykatës është i kufizuar në shqyrtimin e masave të kundërshtuara në kontekstin e të drejtave të Konventës së aplikantit, duke marrë parasysh kufirin e vlerësimit të lënë Shteteve Kontraktuese. Në të njëjtën kohë Gjykata theksoi që edhe nëse një i paraburgosur, nga vetë natyra e situatës së tij, duhet t'i nënshtrohet kufizimeve të ndryshme të të drejtave dhe lirive të tij, çdo kufizim i tillë duhet të jetë megjithatë i justifikueshëm, siç është e nevojshme në një shoqëri demokratike. (...)

Në shqyrtimin e çështjes *Guimon v. France*, Gjykata Evropiane nuk gjeti shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me refuzimin për t'i lejuar një të burgosur të dënuar për vepra terroriste të linte burgun nën shoqërim për të marrë pjesë në funeralin e babait të saj. Gjykata, në vendimin e saj mbajti në konsideratë: (a) profilin kriminal të kërkueses - ajo po vuante disa dënime me burg për veprime terroriste dhe vazhdonte të pohonte anëtarësimin e saj në ETA; (b)

shoqërimi do të duhej të ishte organizuar për një distancë prej gati 650 km dhe rregullat e shoqërimit duhej të ishin veçanërisht të forta; (c) koha në dispozicion për shqyrtimin e kërkesës, pasi të ishte dhënë leja përfundimtare për t'u larguar nën përcjellje, kishte qenë e pamjaftueshme për të rregulluar një shoqërim që përfshin oficerë të trajnuar posaçërisht në transferimin dhe mbikëqyrjen e një të burgosuri të dënuar për vepra terroriste dhe për të organizuar inspektimin paraprak të ambjenteve; (d) aplikanti kishte pasur vizita të rregullta nga anëtarët e familjes dhe miqtë; (e) autoritetet gjyqësore kishin kryer një ushtrim balancues midis interesave në fjalë, përkatësisht, të drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj familjare nga njëra anë dhe sigurisë publike dhe parandalimin e çrregullimit dhe kimit nga ana tjetër [marrë po aty, fq.23-24].

^{xxi} Bëhet fjalë për Ligjin Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Tekstin e plotë mund ta gjeni në linkun vijues:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200702104324ligj%20nr.%2081.%20dt%2025.6.2020.pdf>.

^{xxii} Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve mund të aksesohet në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në linkun vijues:

<http://www.dpsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=516>.

^{xxiii} Për më tepër shih: Ligji Nr. 81/2020, neni 76(1); Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, neni 48(2).

^{xxiv} Për më tepër shih: Council of Europe/European Court of Human Rights, 2021: *Guide on the case law of the European Convention of Human Rights – Prisoner’s rights*, faqe 25, aksesuar në linkun:

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf.

^{xxv} Për sa i përket vizitave bashkëshortore, në çështjen Dickson k. Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ iu referua faktit se më shumë se gjysma e shteteve kontraktuese lejojnë vizita bashkëshortore për të burgosurit, duke iu nënshtuar një shumëllojshmërie kufizimesh. Pavarësisht se shtetet kontraktuese mund të gëzojnë një marrëz të gjerë vlerësimi në përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë për të siguruar pajtueshmërinë me Konventën duke marrë parasysht nevojat dhe burimet e komunitetit dhe të individëve, GJEDNJ vlerëson se çështja e vizitave bashkëshortore padyshim bie brenda fushës së Nenit 8 dhe kufizime të ndryshme në këtë drejtim mund të ngrenë një çështje të diskriminimit sipas Nenit 14 të Konventës [marrë po aty, fq.23].